



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100320/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të burgosurve në
Institucionin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP) Rrogozhinë.

Drejtuar: Z. Agim ISMAILI
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Aleksandër RRËZA
Drejtor i IEVP-së Rrogozhinë

RROGOZHINË

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në neni 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe neni 81 i ligjit 81/2020 "Për trajtimin dhe të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve", kreu inspektimin periodik online, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Rrogozhinë, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit.

Në kushtet e situatës që po kalon Shqipëria për shkak të sëmundjes infektive Covid-19, si dhe në kuadër të respektimit të "Akteve ligjore për COVID-19"¹, duke mbajtur në konsideratë situatën emergjente të krijuar e cila sollti pamundësinë e një inspektimi sipas metodologjisë të ndjekur ndër vite, MKPT-ja si një mënyrë alternative ka zgjedhur për të kryer inspektimet online. Është zgjedhur kjo praktikë e re dhe e domosdoshme për të shmangur rrezikun e infektimit dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të pandemisë duke pasur në fokusin tonë primar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe respektimin e akteve ndërkombëtare për parandalimin e torturës, trajtimit të egër, çnjerëzor e poshtërues. Inspektimet online do të vijojnë, si dhe do të alternohen me inspektimet fizike sipas mundësisë për sa kohë do të jenë në fuqi masat kufizuese për parandalimin e pandemisë.

Inspektimi online u krye në datë 18.02.2021 me drejtorin dhe stafin e institucionit, si dhe në datë 25.02.2021 me një grup të burgosurish. Inspektimi u krye sipas një metodologjie

¹ <https://qbz.gov.al/news/33b00e4f-8efb-4c99-8c45-595cd9b84f1b>

të miratuar për këtë qëllim, bazuar në udhëzimet e OBSH-së dhe CPT-së për monitorimin e respektimit të drejtave të të burgosurve në vendet e privimit të lirisë gjatë periudhës së pandemisë, si dhe eksperiencat e homologëve dhe partnerëve ndërkombëtar. Në përbërje të grupit të inspektimit ishin nd/komisionerët e Mekanizmit Kombëtar z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, znj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita.

Gjatë intervistave, grupi i punës i MKPT-së u fokusua në masat e marra për mbrojtjen dhe sigurinë e personave në ambientet e privimit të lirisë, respektimin e dinjitetit, shëndetit dhe mirëqënies, si dhe rehabilitimin e zhvillimin e mëtejshëm të personave që vuajnë dënimin në këtë institucion.

Objektivi kryesor i vizitës inspektuese (online) ishte vlerësimi i kushteve të I EVP Rrogozhinë, cilësia e trajtimit të të burgosurve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Intervistat online me drejtuesin, stafin dhe të burgosurit e I EVP Rrogozhinë u zhvilluan në kuadër të vizitës monitoruese periodike që kryen MKPT. Vlen të theksojmë se, intervistat online u zhvilluan në frymë shumë të mirë bashkëpunimi.

Në datën 18.02.2021 u zhvillua intervista me drejtorin e institucionit z.Genci Fejzollari, me shefin e sektorit juridik, shefin e sektorit psiko-social dhe shefin e sigurisë të këtij institucioni. Gjatë intervistës, grupi i monitorimit ndoqi të njëjtën metodologji, si në inspektimet fizike, fillimisht duke kërkuar informacion për masat e marra për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19, informacion për verifikimin e kushteve dhe trajtimin e të burgosurve, zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së në inspektimet e mëparshme, si dhe dërgimin e kopjeve të dokumentave kryesore dhe praktikave për secilin sektor në adresën e email-it zyrtar të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjatë intervistës drejtori i institucionit bëri një pasqyrim të situatës aktuale në I EVP Rrogozhinë, duke evidentuar masat e marrat për parandalimin e COVID-19. Sipas informacionit, që nga fillimi i pandemisë dhe aktualisht, në këtë institucion nuk ka patur asnjë të burgosur të prekur nga kjo sëmundje infektive. Ndërsa, nga stafi i punonjësve civil dhe i policisë së institucionit, të evidentuar ishin 8 raste (7 punonjës të policisë në regjimin e jashtëm dhe 1 punonjës civil), të cilët pasi kishin marrë mjekimin e nevojshëm dhe ishin rehabilituar e rikthyer në detyrë.

Punonjësit civil dhe ata të sigurisë, ishin të pajisur me mjete mbrojtëse të siguruara nga institucioni dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si maska, doreza dhe dezifektantë për ruajtjen e higjenes personale. Gjithashtu, ishte bërë dezifektimi i të gjitha ambienteve të institucionit si zyrat, ambientet e përbashkëta, dhomat e banimit, guzhina, SKV etj., në mënyrë periodike çdo dy javë nga një subjekt privat i kontraktuar nga institucioni për kryerjen e këtij shërbimi. Dezifektime shtesë të ambienteve ishin kryer edhe nga Bashkia Rrogozhinë me mjetet dhe fondet e saj, në kuadër të zbatimit të masave anti-COVID-19. Gjatë periudhës së pandemisë, në ndihmë të institucionit ka patur edhe donacione nga

Bashkia Rrogozhinë dhe subjekte private për furnizimin me pajisje mbrojtëse ndaj COVID-19 të punonjësve.

Në hyrje të institucionit është vendosur një “urë dezinfektuese” për kalimin e stafit dhe të vizitorëve, si dhe ju matet temperatura, para hyrjes në ambientet e institucionit. Kjo praktikë kryhet çdo ditë dhe evidentohet në një regjistër të veçantë nga punonjësit e informacionit.

Gjithashtu, grupi i monitorimit u informua se, drejtuesit e institucionit dhe punonjësit gjatë orarit të punës, zbatojnë me korrektësi protokollin e vendosur për parandalimin e COVID-19, që ka të bëjë me distancimin fizik sidomos me të burgosurit, mbajtjen e maskave mbrojtëse, kontrollin me imtësi të hyrjes të pakove ushqimore për të burgosurit dhe ruajtjen e tyre deri në dy orë në një ambient të veçantë, afishimin në ambientet e jashtme dhe të brendshme të regjimit të masave për parandalimin e pandemisë, higjenizimin e vazhdueshëm të ambienteve të brendshme të institucionit etj.

Në vijim, nga intervista rezultoi se me Urdhër Nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, I EVP Rrogozhinë kategorizohet “*Burg i sigurisë së zakonshme*”. Kapaciteti fizik i institucionit është për mbajtjen dhe trajtimin e **338 persona të burgosur**. Në datën që u zhvillua intervista online, në institucion ndodheshin 240 të burgosur, pra nuk kishte situatë mbipopullimi.

Situata e popullimit në I EVP Rrogozhinë, u monitorua dhe për periudhën e fundit 6 mujore, ku nga informacioni rezultoi si më poshtë vijon:

- Janar 2021 241 të dënuar
- Dhjetor 2020 240 të dënuar
- Nëntor 2020 244 të dënuar
- Tetor 2020 255 të dënuar
- Shtator 2020 249 të dënuar
- Gusht 2020 259 të dënuar

Organika e institucionit përbehej nga 213 punonjës, nga të cilët 38 punonjës civil dhe 175 punonjës të sigurisë së burgut. Bazuar në strukturën e miratuar, mungesat konsistojnë në plotësimin e organikës me 9 punonjës policie të nivelit bazë dhe 1 punonjës civil në sektorin e çështjeve shoqërore. Mungesat në stafin e institucionit, sipas intervistës me drejtorin e institucionit, nuk ndikonin në vijueshmërinë e punës dhe ofrimin e shërbimeve bazë ndaj të burgosurve.

Grupi i inspektimit, me qëllim vlerësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimin e të dënuarve në këtë institucion, zhvilloi një seancë intervistimi online edhe me një grup prej 5 të burgosurish (sipas sektorëve) më datë 25.02.2021. Intervistimi i të burgosurve u krye në njërin prej ambienteve të krijuar për komunikimin online me familjarët, duke garantuar kushtet e konfidencialitetit, me qëllim që në dhomën e intervistimit mos të kishte asnjë punonjës të shërbimit të sigurisë apo staf civil të këtij institucioni.

Nga intervista me të burgosurit, u ngritën ankesa që kishin të bënin me nivelin e lartë të lagështisë e cila ishte prezente në disa nga dhomat e banimit dhe ndikonte në shëndetin e të burgosurve; mungesa e larmishmërisë së menisë ushqimore; kufizimi i aktiviteteve për

shkak të pandemisë COVID-19; minutazhi i shkurtër i bisedave me kartat telefonike, ku nga 120 min që ishte para një viti, e njëjta kartë aktualisht kishte 60 min për të komunikuar me familjarët, ndërkohë që çmimi i kartës nga kompania private nuk ka ndryshuar.

Të burgosurit ngritën me shqetësim disa ankesa që kishin të bënin me mungesën për një kohë të gjatë të takimeve fizike me familjarët e tyre gjatë periudhës së pandemisë, pavarësisht se nga ekspertët e shëndetësisë janë lejuar disa masa më lehtësuese. Ata kërkonin nga DPB-ja gjetjen e mënyrave të tjera alternative për takimet me familjet e tyre (përveç komunikimit online), pasi kjo situatë pandemie mundet të vazhdojë për një kohë të gjatë dhe nuk është e ligjshme që kjo e drejtë t'ju mohohet të burgosurve për një periudhë të pa caktuar.

Ndërkohë, një grup ankesash kishin të bënin me zvarritjen prej disa vitesh të shqyrtimit të çështjeve që ndodheshin për rekurs në Gjykatën e Lartë; kërkesa për një amnisti të përgjithshme; ankesa për Gjykatën e Shkallës së Parë Kavajë në lidhje me vendimet për të përfituar ulje të dënimit deri 90 ditë² në çdo vit për çdo të dënuar që zbaton rregullat e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka një sjellje të mirë duke e treguar me pjesëmarrje aktive dhe pozitive në veprimtaritë rehabilituese dhe riintegruese gjatë kryerjes së dënimit. Por, pavarësisht raportit të vlerësimit të institucionit për sjellje të mirë gjatë periudhës së kryerjes së dënimit, ata pretendonin se gjykata jep vendime për ulje dënimi deri në 50 apo 60 ditë.

Në lidhje me këto ankesa, të intervistuarve ju bë me dije nga grupi i inspektimit se, pavarësisht se këto ankesa nuk janë në juridiksionin dhe kompetencën e Institucionit të Avokatit të Popullit, ato do t'ju adresohen nga ana jonë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe organeve të larta të drejtësisë.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së nga inspektimi i mëparshëm, sipas informacionit të dhënë nga drejtuesi, stafi i institucionit, si dhe intervistat e zhvilluara me personat e dënuar, rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar** rekomandimi për përmirësimin e kushteve të jetesës në dhomat e të burgosurve, riparimin e tualeteve dhe përmirësimin e higjienës në dhoma, duke krijuar kushte të përshtatshme për një jetë dinjitoze.
2. **Ishte zbatuar** rekomandimi për kryerjen e investimeve në ambientet e veçimit dhe të observimit, me qëllim minimizimin e lagështirës në dhoma, pajisjen e tualeteve me dyer të reja, vendosjen e lavamanëve dhe dusheve të përbashkëta për çdo dy dhoma, lyerja me gëlqere, si dhe kryhej dezinfektim i vazhdueshëm i këtyre ambienteve.
3. **Ishte zbatuar** rekomandimi për pajisjen e dhomave të veçimit me tavolina, e komodina për vendosjen e rrobave në mënyrë që të mundësohet ngrënia e ushqimit dhe kushtet bazë të jetesës në mënyrë dinjitoze dhe njerëzore.
4. **Ishte zbatuar** rekomandimi për riparimin e boljerëve për sigurimin e ujit të ngrohtë për larje në sektorin e veçimit, atë të observimit dhe në ambiente të tjera ku ato ishin evidentuar me defekt nga grupi i inspektimit.
5. **Ishte zbatuar** rekomandimi për riparimin e nyjeve hidrosanitare në banjo dhe krijimin e kushteve higjienike për një dizinfektim të vazhdueshëm.
6. **Ishte zbatuar** rekomandimi për plotësimin e stafit mjekësor dhe psiko-social me personelin e nevojshëm.

² Neni 75 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

7. **Ishte zbatuar** rekomandimi për furnizimin e kabinetit të stomatologut me instrumente dhe materiale dentare, me qëllim ofrimin e një shërbimi stomatologjik cilësor dhe në kohë me ndërhyrjet përkatëse.
8. **Ishte zbatuar** rekomandimi për pajisjen e të gjithë të dënuarve/ paraburgosurve të këtij institucioni me librezë shëndetësore dhe kodin e pacientit sipas kërkesave të Fondit të Sigurimeve të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH-së).
9. **Ishte zbatuar** rekomandimi për vënien në zbatim të marrëveshjes trepalëshe ndërmjet FSDKSH-së, I EVP-së dhe depos farmaceutike, në mënyrë që të vihet në funksion skema e rimbursimit të ilaçeve si për sëmundjet kronike ashtu dhe për ato të urgjencës, duke siguruar kështu një furnizim të rregullt të këtij institucioni me medikamente.
10. **Ishte zbatuar** rekomandimi për problemin e mbipopullimit, për të bërë të mundur krijimin e ambienteve të veçanta për këshillime individuale, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve me grupe të vogla të dënuarish.

Sa i takon interesimit të grupit të monitorimit, në lidhje me fondin për investime nga buxheti i shtetit për vitin 2020, nga informacioni i drejtorit të institucionit rezultoi se, nuk ishte miratuar asnjë investim për I EVP Rrogozhinë, me përjashtim të investimeve të kryera nga donatorë ose me fondet e vetë institucionit. Po kështu, edhe për vitin 2021 deri në momentin e kryerjes së inspektimit, nuk ishte miratuar asnjë prej projekteve prioritare që kishte kërkuar ky institucion siç janë, projekti për shkarkimin e ujrave të bardha dhe ujrave të zeza, si dhe projekti për rikonstruksionin e plotë të rrjetit të brendshëm elektrik.

Ndërkohë, nga intervistat rezultoi se disa rekomandime nuk kishin gjetur zbatim dhe nuk ishin plotësuar. Më konkretisht:

1. **Nuk ishte plotësuar** rekomandimi, për investime në riparimin e instalimeve elektrike, si dhe disiplinimin e lidhjeve elektrike provizore të ekspozuara në dhomat e banimit, sipas normave të sigurimit teknik, pasi përbëjnë rrezik për sigurinë e jetës të të dënuarve.
2. **Nuk ishte plotësuar** rekomandimi, për eliminimin e lagështirës në të gjitha dhomat e banimit të të dënuarve.
3. **Nuk ishte plotësuar** rekomandimi, për ofrimin e kurseve profesionale në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional dhe organizatat jo fitimprurëse, që veprojnë në Bashkitë e Rrogozhinës dhe të Kavajës.

1. Trajtimi

Grupi i inspektimit të MKPT-së, gjatë intervistave online kishte për qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave që vuajnë dënimin në këtë institucion; kushtet e jetesës; identifikimin e rasteve të përdorimit të dhunës apo përdorimin e forcës fizike nga punonjësit e sigurisë tej kufijve të parashikuar në aktet normative, si dhe aktet ndërkombëtare; funksionimi i sistemit për zgjidhjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve; procedurat që ndiqen nga komisionet e ngritura me urdhër të drejtorit të institucionit si komisioni i pritjes, komisioni i dhënies së masave disiplinore, komisioni për verifikimin e çmimeve të mallrave dhe ushqimeve që tregtohen nga njësitë tregtare që ndodhet në këtë institucion, në raport me çmimet e tregut; llojet e aktiviteteve që janë zhvilluar kryesisht gjatë periudhës së pandemisë; trajtimi shëndetësor i të dënuarve; cilësia e gatimit të ushqimit; furnizimi sipas normativave me detergjente dhe mjetet e higjienës personale etj.

Nga intervistat e zhvilluara me të burgosurit, gjatë vitit 2020 grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkallim të forcës nga ana e personelit të sigurisë në këtë institucion. Raporti dhe mardhëniet e stafit të institucionit me të burgosurit, kanë qenë korrekte dhe në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Infrastruktura dhe kushtet fizike të ndërtesave ku ndodhen zyrat e administratës dhe godinat që shërbejnë për banim në regjimin e brendshëm, janë të amortizuara, për shkak se këto ndërtesa janë ndërtuar që në vitin 1958. Por, nga informacioni dhe intervistat rezultoi se, godinat për banim të të burgosurve janë në gjendje relativisht të mirë, pasi janë mirëmbajtur me investime të pjesëshme që janë kryer në vite. Gjatë vitit 2020 ka patur një ndërhyrje të plotë me insvetime në godinat e regjimit të brendshëm, kjo për shkak të lirit të ambienteve dhe kapacitetit të ulët të numrit të të dënuarve në dhomat e banimit, si dhe mundësisë për krijimin e ambienteve të reja si për këshillime psiko-sociale, ashtu edhe për zhvillimin e aktiviteteve rekreative me grupe të dënuarish.

Regjimi i brendshëm ka 3(tre) godina, në të cilat janë akomoduar të dënuarit e sigurisë së zakonshme, ndërsa kategoria e të dënuarve të moshës 18-21 vjeç (gjithsej 15 të dënuar) janë të integruar në një nga sektorët e këtij regjimi dhe janë të akomoduar në dhoma më vete nga të dënuarit e tjerë. Gjithashtu, ajrimi dhe aktivitetet e tjera me këto moshë, si ato me karakter këshillimor dhe edukativ, zhvillohen në orare të ndara nga grup moshat e tjera të të burgosurve.

Sikurse theksuam edhe më lart, nga intervistat me të burgosurit, rezultoi se ankesat më të shumta kishin të bënin me mungesën e takimeve fizike me familjet e tyre, për një periudhë një vjeçare. Sipas informacioneve, situata e pandemisë dhe masat kufizuese në burgje do vazhdojnë të ruhen për një kohë ende të pacaktuar, ndaj ata ngrinin shqetësimin për gjetjen e mënyrave alternative për realizimin e takimeve me familjarët e tyre, përveç takimeve online. Ata kërkonin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të krijohen në çdo I EVP ambiente të veçanta për takimin e të burgosurve me fëmijët dhe familjarët, në dhoma të ndara në mes me materiale të tejdukshme, që lejojnë shikimin dhe komunikimin, por që kufizojnë kontaktin fizik mes tyre. Kjo, do të ishte një mënyrë më lehtësuese për mundësimin e takimeve me familjet e tyre, e cila do të ndikonte gjithashtu dhe në gjendjen shpirtërore dhe psikologjike të të burgosurve.

Në lidhje me aktivitetet që zhvillohen në regjimin e brendshëm, të burgosurit referuan ankesa se periudha e gjatë e pandemisë ka kufizuar në maksimum zhvillimin e veprimtarive masive me karakter kulturor dhe edukativ, të cilat vazhdojnë të mungojnë ende pavarësisht lehtësimit të masave parandaluese ndaj kësaj pandemie. Të vetmet aktivitete ku marrin pjesë të burgosurit ishin ajrimi, lojrat e tavolinës dhe koha e ushtrimit në palestër, sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit. Të intervistuarit, kërkonin që në këtë aspekt, të burgosurit të lejoheshin të zhvillonin aktivitete me grupe në klasat e edukimit edhe gjatë orarit të mbasditeve, natyrisht sipas orareve të miratuara, pasi që prej orarit të drekës atyre nuk ju lejohet të dalin nga dhomat e tyre të banimit.

Në I EVP Rrogozhinë, ishin të punësuar 34 të burgosur, nga 35 vetë që ishin të miratuar në organikë, në pozicione pune si ndihmës kuzhiner, lavanderi, sanitarë etj. Të punësuarit, përfitojnë ulje dënimi me 3.9 ditë në muaj dhe shpërblim financiar në vlerë minimale, e cila depozitohej në numrin e llogarisë të secilit të punësuar.

Të burgosurit e intervistuar, ngritën si nevojë shtimin e kontakteve të përditëshme të juristit dhe stafit për çështjet shoqërore me të burgosurit, në lidhje me ankesat dhe problematikat e ndryshme që shqetësojnë të burgosurit, si dhe ti informojnë në kohë mbi ecurinë e zgjidhjes së ankesave.

Nga informacioni i drejtuesit të institucionit, në ambientin e dhomave të observimit ndodheshin 3 të burgosur për mospërshtatje, të cilët kishin mbi 15 ditë qëndrimi në këto ambiente, me kërkesën e vetë të dënuarve. Ndodhur në kushtet që këta të burgosur nuk janë përshtatur me sektorët në këtë institucion, IEVP Rrogozhinë kishte njoftuar me informacion DPB, për të mundësuar transferimin e tyre në institucionet e tjera, por aktualisht për shkak të situatës së pandemisë nuk janë kryer veprime për transferimin e të burgosurve.

Në rastin kur një regjim i tillë imponohet ose zbatohet me kërkesë nga vetë i dënuari për arsye mospërshtatje, një garanci thelbësore është prezenca e vazhdueshme e mjekut në ambientet e observimit, me synimin që personeli mjekësor të kryejë vezhgim dhe ekzaminimin mjekësor të të burgosurve në mënyrë të vazhdueshme. Rezultatet e këtyre ekzaminimeve, përfshirë këtu një përshkrim të gjendjes fizike dhe mendore, si dhe pasojat e parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet t'u paraqiten rregullisht me anë të një deklarate me shkrim nga ana e mjekut, autoriteteve kompetente për çështjet e regjimit dhe sigurisë në IEVP.

2. Masat mbrojtëse

Në intervistat online me të burgosurit dhe stafin e institucionit, grupi i inspektimit kërkoi informacion në lidhje me funksionimin e sistemit të kërkesë/ankesave³. Nga përgjigjet e tyre, rezultoi se sistemi i kërkesë/ankesave në këtë institucion, funksionon mbi bazën e urdhërit të DPB-së, ku përcaktohen personat përgjegjës të cilët janë të autorizuar të marrin kërkesë/ankesat e të burgosurve, mënyrën e regjistrimit dhe protokollimit të tyre në regjistrin përkatës, si dhe trajtimin e ankesave dhe kthimin e përgjigjes së tyre, brenda afatit të përcaktuar nga titullari i institucionit. Kërkesë/ankesat e të burgosurve që i adresohen institucioneve të tjera shtetërore, dërgohen për t'u nisur me postë nga një punonjës i institucionit i ngarkuar nga drejtuesi i institucionit.

Nga intervistat me të burgosurit, nuk kishte ankesa në lidhje me kthimin e përgjigjes nga ana e institucionit për ankesat ose kërkesat. Kryesisht, kthimi i përgjigjes bëhet me shkrim, por edhe verbalisht nga punonjësit e çështjeve shoqërore, sipas detyrave të lëna nga drejtori i institucionit, brenda afatit kohor të parashikuar në ligj⁴.

Grupi i monitorimit, kërkoi informacion në lidhje me procedurat që ndiqen nga Komisioni i Pritjes të të paraburgosurve në institucion, Komisioni Disiplinor për dhënien e masave disiplinore, si dhe për mënyrën e plotësimit të regjistrave dhe dosjeve personale të të burgosurve. Nga intervista me drejtuesin e institucionit, si dhe verifikimet e dokumentacionit të dërguar me email sipas sektorëve, u konstatua se zbatohen me korrektësi procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, në lidhje me pranimin e të burgosurve në institucion, për dhënien e masave disiplinore, si dhe për plotësimin e dokumentacionit që ndodhen në dosjet personale të të burgosurve.

³ Neni 58 pika 5 e ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

⁴ Neni 58 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Nga drejtori i institucionit, u informuam se për çdo të burgosur tashmë funksionon **kartela personale elektronike**, e cila plotësohet dhe përditësohet me shënime nga punonjësit e sektorëve përgjegjës sipas fushave që mbulojnë, kartelë e cila e shoqëron të burgosurin gjatë gjithë kohës së qëndrimit në I EVP, pavarësisht transferimeve që mund të ndodhin me të burgosurin nga njëri institucion në tjetrin, qoftë për arsye personale e familjare, apo për arsye të sigurisë.

Komunikimi me familjarët, për shkak të masave anti-COVID-19, realizohej përmes takimeve online dhe bisedave me telefon. Nga intervistat me të burgosurit, u evidentua se takimet online me familjet e tyre kryheshin 4 herë në muaj nëpërmjet platformës “Skype”, të instaluar në kompjuterat që ndodheshin në dy ambientet e dy dhomave, të krijuara vetëm për këtë qëllim. Ndërkohë, bisedat me telefon kryheshin 8 herë në muaj, nëpërmjet telefonave me kartë, aparatet e të cilëve ishin të instaluar në mjedisin e regjimit të brendshëm.

Sikurse përmendëm edhe më lart, të paraburgosurit ngritën si shqetësim uljen e minutave të bisedës në kartat telefonike, nga 120 min në 60 min kohë bisede, ndërkohë që çmimi i kartave ka mbetur i njëjtë nga kompania private e miratuar për ofrimin e këtij shërbimi.

Sipas informacionit, institucioni kishte të instaluar 32 kamera në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm, për mbajtjen nën mbikqyrje të të gjitha ambienteve. Për arsye të rritjes së sigurisë dhe garantimit të të drejtave të burgosurve, institucioni ka bërë kërkesë DPB-së për shtimin e numrit të kamerave dhe vendosjen e tyre kryesisht në ambientet e të gjitha koridoreve në regjimin e brendshëm, si dhe në dhomat e veçimit dhe të observimit. Monitorimi me kamera kryhej përgjatë 24 orëve.

Grupi inspektimit i kushtoi rëndësi dhe afishimit të posterave me të drejtat e të burgosurve, kryesisht në ambientet e koridoreve të dhomave të banimit dhe ambientet e përbashkëta si klasat, bibliotekat etj. Nga informacioni me drejtorin dhe stafin e institucionit, rezultoi se ato janë të afishuara në të gjitha ambientet e regjimit të brendshëm, por ato kanë nevojë të rifreskohen me postera të rinj. Gjithashtu, ata na informuan se, në vende që janë të aksesueshme për të burgosurit, janë të afishuar edhe numrat e telefonit të Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH), si dhe OJF-ve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Nga informacioni i drejtorit të institucionit, u nënvizua fakti se të burgosurve ju ofrohet rregullisht ndihmë juridike falas, nga OJF që kanë lidhur marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë.

Nga intervista me stafin e institucionit, u informuam në lidhje me marrjen e masave në bashkëpunim me Bashkinë Rrogozhinë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Kodi Zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, për garantimin e të drejtës së votës të të burgosurve. Aktualisht, ishin marrë masa për ngritjen e QV-së në ambientet e brendshme të këtij institucioni, si dhe për verifikimin e dosjeve të të burgosurve dhe përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve. Në bazë të kërkesave të nenit 2, pika 1, të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nga 240 të burgosur vetëm 66 prej tyre plotësonin kriteret për të ushtruar të drejtën e votës në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021.

3. Kushtet materiale

Grupi i inspektimit në intervistat online me stafin e institucionit dhe në veçanti në intervistat me të burgosurit, u ndal në gjendjen e kushteve fizike në të cilën ndodhen dhomat e banimit, dhomat e veçimit dhe dhomat e observimit, si dhe në plotësimin e kushteve materiale të të burgosurve për një jetesë normale.

Sikurse përmendëm dhe më lart, ndërtesat e këtij institucioni për shkak të kohës kur ato janë ndërtuar, ishin të amortizuara. Megjithatë nga informacioni rezultoi se, gjatë dy viteve të fundit janë kryer disa investimeve të pjesshme, ndaj gjendja në dhomat e banimit është e përmirësuar dhe ato janë të mirëmbajtura.

IEVP Rrogozhinë ka 1(një) regjim të sigurisë të zakonshme me 3 godina njëkatëshe. Çdo godinë ka nga 6 dhoma të ndara dy e nga dy në formë apartamenti. Tualetet janë të përbashkëta për çdo apartament me 2 dhoma dhe në pjesën e jashtme të dhomave gjendet një korridor, i cili shërben njëkohësisht dhe si ambient për gatimin e ushqimit. Dhomat e banimit të të burgosurve janë me përmasa të tilla ku akomodohen 4, 6 dhe 8 persona, që nuk plotësojnë kriteret për jetesë normale.

Lidhur me këtë konstatim, Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT) me rastin e vizitës në Shqipëri, në vitin 1997, i ka rekomanduar autoriteteve Shqiptare: *“Të dënuarit/paraburgosurit të akomodohen në dhoma jo me pak se 22 m² në rastet kur vendosen 6 veta në dhomë dhe 10m² në rastet kur vendosen 2 veta në dhomë. Gjithashtu, dhomat më të vogla se 6m² nuk plotësojnë standardet minimale për një dhomë burgu dhe duhet të nxirren jashtë shërbimi”*.⁵ Situata e popullimit i përgjigjet mundësive dhe kapaciteteve që ka institucioni, por në IEVP Rrogozhinë ekziston mundësia e investimeve në godinat e tjera të banimit në regjimin e brendshëm, për të zgjeruar hapsirat për dhoma të reja dhe uljen e numrit të të burgosurve për çdo dhomë.

Sipas informacionit, dritaret e dhomave janë me përmasa të mëdha dhe mundësojnë ndriçim natyral dhe ajrosje të përshtatshme, ndërkohë që kushtet higjieno sanitare në dhomat e banimit, koridoret dhe tualetet janë të mira.

Ngrohja në dhoma sigurohej me ngrohëse elektrike, pasi institucioni nuk ka sistem qëndror ngrohje. Gjithashtu dhe gatimi i ushqimit nga të burgosurit, kryhej me pajisje elektro-shtëpiake të siguruara nga familjarët e tyre.

Larja e trupit kryhej rregullisht 4 herë në muaj, por në varësi të stinës dhe 2 herë në javë. Dushet ishin të instalura në të njëjtin ambient të përbashkët me tualetet. Në lidhje me mbajtjen e higjenës në kushtet e burgimit, në pikën 19.4 të Rregullave Evropiane të Burgjeve thuhet shprehimisht se, *“Çdo të burgosuri duhet t'i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëjë dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën. Kur është e mundur dushi mund të bëhet çdo ditë, ose të paktën dy herë në javë (ose më shpesh nëse është e nevojshme) në interes të higjenës së përgjithshme”*.⁶

⁵ Albania: Visit 1997 [par.127]

⁶ <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

Në kushtet kur ngrohja, larja e trupit dhe gatimi kryheshin me pajisje elektrike, kjo sillte si pasojë ngarkesa në sistemin elektrik. Problemet me instalimet dhe rrjetin elektrik të konstatuara edhe në inspektimin e MKPT-së në vitin 2018, vijonin të ishin prezente, duke rrezikuar seriozisht jetën e të dënuarve. Megjithëse ishin marrë masa për riparimin e tij, rrjeti elektrik ngelet tejet i amortizuar dhe i mbingarkuar nga lidhjet provizore amatore, duke mos e përballuar ngarkesën elektrike në godina.

Dhomat e banimit janë të kompletuara me të gjitha materialet për fjetje dhe orënditë e nevojshme si tavolina, karrige dhe komodina, për një jetesë normale. Për shkak të numrit të ulët, mundësitë e institucionit për kompletimin e të burgosurve me materiale si batanie, dyshek, jastek dhe çarçaf, janë më të mëdha. Kjo u evidentua edhe në intervistat me të burgosurit, të cilët deklarorin se nuk kishin probleme me furnizimin me materiale të fjetjes dhe orënditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimeve.

Një çështje tjetër që u evidentua nga intervistat me të burgosurit, për shkak dhe të masave të shtuara për parandalimin e COVID-19, ishte dhe furnizimi me detergjente dhe materiale higjienike, mbi normativën e lejueshme. Të burgosurit deklarorin se ambientet e dhomave të banimit, tualetet, koridoret dhe klasat e edukimit janë dezinfektuar pothuajse çdo javë gjatë periudhës së pandemisë. Gjithashtu, ata deklarorin se kanë patur furnizim të rregullt me detergjentë dhe materiale higjienike, për mbajtjen e pastërtisë në dhoma dhe ruajtjen e higjienës personale.

Sipas informacionit të siguruar nga intervistat me të burgosurit, higjiena në mjediset e banimit, në korridoret dhe ambientet e përbashkëta, si dhe në kuzhinën e institucionit është relativisht e kënaqshme, pasi dhe gjendja e amortizuar e godinave nuk e mundëson më shumë.

Larja e materialeve të fjetjes si çarçafë, jastekë dhe batanijet e të burgosurve, kryhet në lavanterinë e institucionit e cila ishte funksionale. Ajo ishte e kompletuar me 11 lavatriçe dhe kishte të punësuar një punonjës civil dhe një të dënuar të punësuar nga institucioni. Ndërkohë, që rrobat për larje të dënuarve në shumicën e rasteve ua mundësonin familjarët e tyre.

Një nga problemet e vazhdueshme të këtij institucioni që u evidentua në ankesat e të burgosurve, ishte prezenca e parazitëve, furrtarëve dhe insekteve të tjerë, për shkak edhe të zonës ku është i dislokuar IEVP Rrogozhinë. Kjo u evidentua si problematikë edhe në intervistën e zhvilluar me stafin e institucionit, por sipas tyre ambientet e institucionit dezinfektoheshin në mënyrë të përgjithshme 2 herë në vit, nëpërmjet shërbimit 3D (DEZINFEKTIM – DEZINSEKTIM – DERATIZIM) të ofruar sipas kontratës me institucionin nga një kompani private. Pavarësisht kësaj, ky problem ende ngelet i pazgjidhur.

Në intervistat me të burgosurit rezultoi se, ushqimi i gatuar nga kuzhina e institucionit, ishte i një cilësie të kënaqshme. Menyja e përditshme është e afishuar në kuzhinë, me gramaturat dhe e ndarë më vete për të burgosurit, për të punësuarit dhe për të sëmuret me dietë ushqimore. Kampionët e ushqimit ruhen në kushte frigoriferike. Kuzhina është e kompletuar me 2 frigorifer ngrirës, një frigorifer ftohës dhe një aspirator. Stafi i kuzhinës ishte i plotësuar sipas organikës me 4 punonjës civil dhe 4 ndihmëskuzhiner nga rradhët e të dënuarve të punësuar. Ata janë të pajisur me librezë shëndetësore.

Gjatë vitit 2020 në ambientin e kuzhinës ishin kryer disa investime dhe konkretisht ajo është shtruar me pllaka të reja, si dhe është bërë funksional kanalizimi i shkarkimit të ujrave të kuzhinës. Nga intervistat me të burgosurit, rezultoi se në përgjithësi ata e konsumonin ushqimin e institucionit, por një pjesë e tyre gatuanin vetë ose merrnin ushqime nga familjarët. Problematike ngelet, menyja e ushqimit e cila ishte e njëjtë për çdo ditë dhe nuk ishte e larmishme, gjë që u ngrit si shqetësim nga të dënuarit.

Sipas informacionit, kushtet materiale në dhomat e seksionit të veçimit dhe të observimit janë përmirësuar, duke i plotësuar ato me materiale fjetje dhe orenditë e nevojshme. Gjithashtu, në këto ambiente ishin kryer disa ndërhyrje të pjesshme me investime, pasi gjendja e tyre është konsideruar edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit në inspektimin e kryer në vitin 2018, mjaft problematike dhe në limitet e trajtimit degradues të të burgosurve që ndodheshin në ato ambiente. Aktualisht në dhoma e veçimit dhe të observimit është ulur niveli i lagështirës, si dhe janë të lyera dhe të pastra nga ana higjieno sanitare. Çdo tualet është plotësuar me nrye hidrosanitare, rubineta dhe lavaman të rinj, si dhe janë vendosur dyer alumini.

Në ditën e intervistimit online, në këto ambiente nuk kishte asnjë të burgosur me masë disiplinore, ndërsa në dhomat e observimit ndodheshin 5 të burgosur për mospërshtatje, nga të cilët 2 prej tyre kishin mbi 20 ditë qëndrimi në këto ambiente, por qëndronin aty me kërkesën e tyre, deri në mundësimin e një transferimi për në IEVP tjetër nga DPB-ja.

Në ambientet e observimit të burgosurit që hyjnë rishtaz në institucion, nuk mund të qëndrojnë më shumë se 15 ditë, deri në sistemin e tyre në një nga sektorët e regjimit të brendshëm. Në të kundërt, në rast mospërshtatje brenda sektorëve të institucionit, DPB-ja duhet të marrë masa për transferimin e tyre në një institucion tjetër, gjë e cila ende nuk është miratuar, pavarësisht kërkesave të drejtorit të IEVP Rrogozhinë.

4. Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktiviteti i të burgosurve në IEVP Rrogozhinë, ishte i përcaktuar në orarin e veprimeve ditore të miratuar nga drejtori i institucionit. Në mungesë të veprimtarive me pjesëmarrjen e të gjithë të dënuarve, për shkak të respektimit të masave anti-COVID 19, institucioni kishte krijuar dhe 3 klase të reja që shërbenin për aktivitete në grupe deri në 16 veta, si dhe për këshillime individuale. Gjithashtu, nga informacioni rezultoi se biblioteka e institucionit ishte funksionale dhe kishte 120 tituj me libra, por ajo ka nevojë të pasurohet me tituj të rinj, pasi gjatë periudhës së pandemisë ishte rritur interesi i të dënuarve për frekuentimin e leximit të librave. Në këtë institucion janë funksionale dhe 2 ambiente kulti për besimtarët myslyman dhe për besimtarët e krishterë, por që gjatë periudhës së pandemisë nuk janë zhvilluar rite fetare.

Në lidhje me ajrimin, institucioni kishte 3 ambiente ajrimi të veçanta për çdo sektor. Orari i ajrimit ishte i përcaktuar në orarin ditor dhe nuk kishte ankesa nga të burgosurit në lidhje me respektimin e tij nga punonjësit e sigurisë të institucionit. Ngjitur me ambientet e ajrimit është dhe një fushë futbollit, në të cilën nuk lejohen të zhvillohen aktivitete sportive masive, por me grupe më të vogla.

Në IEVP Rrogozhinë është funksionale palestra, e cila është e pajisur me vegla force dhe qëndron e hapur sipas orarit të miratuar. Të dënuarit ushtrohen në palestër me grupe sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit.

Sikurse përmendëm edhe më lart, në intervistat me të burgosurit u ngrit si shqetësim ndërprerja e aktiviteteve në grup apo atyre me pjesmarrje të gjerë, për shkak të gjendjes së pandemisë. Pavarësisht këtyre masave, aktivitetet me të burgosurit nuk duhen të ndërpriten, pasi një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është ri-integrimi në shoqëri i personave, në momentin kur ata do të lenë burgun, ndaj dhe Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁷.

Në këtë kuadër, Mekanizmi Kombëtar, thekson nevojën që sektori psiko-social të hartojë programe këshillimi për trajtimin individual të këtyre personave sipas grup moshave, të ndërthurura me zhvillimin e aktivitete me grupe sa më të vogla personash, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet te këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive, gjatë kësaj periudhe.

Stafi i sektorit të çështjeve shoqërore i institucionit ka 7 punonjës në organikë, nga të cilët 6 psikolog (punonjës social) dhe një shef sektori. Aktualisht, mungon vetëm një specialist psikolog.

Nga dokumentacioni i dërguar nga stafi i institucionit rezulton se, sektori i çështjeve shoqërore kishte plan vjetor dhe mujor për zhvillimin e aktiviteteve me të burgosurit të ndarë më vehte për moshat 18-21 vjeçar dhe për grup moshat e tjera.

Në IEVP Rrogozhinë funksionon në një ambient më vehte edhe shkolla 9-vjeçare, në të cilën janë të regjistruar 32 të dënuar. Mësimi zhvillohet normalisht çdo ditë nga ora 09.00-13.00 dhe nuk është ndërprerë as gjatë periudhës së pandemisë. Stafi i mësuesve është i përbërë nga 4 vetë dhe i miratuar nga drejtoria e zyrës arsimore Kavajë. Mësuesit janë siguruar nga shkolla 9-vjeçare “Xhorxh Soros”, Rrogozhinë.

5. Shërbimi shëndetësor

Organika e stafit shëndetësor të IEVP Rrogozhinë ishte e plotësuar. Ajo përbëhet nga 9 punonjës, prej të cilëve 2 mjekë, 1 stomatolog, 1 farmacist dhe 5 infermjerë me kohë të plotë.

Nga intervistat me të dënuarit nuk u konstatuan ankesa përse i përket ofrimit të shërbimit shëndetësor. Krahas shërbimit mjeksor që ofrohej në institucion, të burgosurit mund të merrnin shërbim mjeksor edhe te mjekët specialist në Spitalin Rajonal të Kavajës, sipas rekomandimit të mjekut të institucionit. Por, nga intervistat me të burgosurit u evidentua fakti se, gjatë periudhës së pandemisë vizitat mjeksore te mjekët specialist ishin më të

⁷Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

reduktuara, kjo për shkak të karantinimit deri në 14 ditë në mjediset e dhomave të observimit, sipas urdhërit në fuqi të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Në lidhje me këtë situatë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar dhe ka mbështetur tërësinë e masave të ndërmara nga strukturat drejtuese në sistemin penitenciar për parandalimin e përhapjes të sëmundjes infektive COVID-19, por njëkohësisht ka rekomanduar që kufizimet e vendosura të jenë proporcionale dhe të garantojnë të drejtat ligjore të të burgosurve, kryesisht të drejtës për të marrë shërbim shëndetësor më të specializuar pranë spitaleve rajonale.

Në këtë kontekst, edhe njëherë sjellim në vëmendjen tuaj qëndrimet e CPT-së për këtë çështje, ku parashikohet se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre”* dhe se *“shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*, si dhe Rregulloren Evropiane të Burgjeve ku përcaktohet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*⁸.

Ambienti ku zhvillohen vizitat mjeksore ishte rikonstruktuar nga “Shoqata Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë” financuar nga Mbretëria e Hollandës, në të cilën përfshihen dhoma e mjekut, si dhe dhoma për shtrimet ambulatorie me 6 shtretër. Në këtë ambient mbahen regjistrat në lidhje me vizitat mjeksore që kryhen me të burgosurit, kartelat mjeksore, si dhe regjistri për rastet e përdorimit të formave shtërnguese të forcës për pacientët dhe evidentimit të dhunës.

Në funksion të këtij shërbimi, në IEVP Rrogozhinë funksionon dhe SKV (Seksioni i Kujdesit të Veçantë) ku trajtohen të sëmurë kronikë, i cili ndodhet në godinën 2, sektori 3. Në këtë seksion ndodhen 4 dhoma dhe në momentin e zhvillimit të intervistës online ishin të shtruar 13 persona. Nga të shtruarit, 5 persona ishin me varësi të përdorimit të drogës dhe trajtohen me medikamentin “metadon”, që sigurohet nga shoqata “Aksion plus”, Tiranë.

Sipas informacionit, në këtë institucion kishte një statistikë mujore të personave që trajtoheshin për probleme të shëndetit mendor, apo për sëmundje kronike, kardiake, neurologjike, nefrologjike, gastro-intestinale etj, të cilat raportohen çdo muaj në DPB.

Dhoma e mjekut ishte e pajisur me orenditë e domosdoshme për kryerjen e vizitave mjeksore. Gjithashtu, dhoma e stomatologut ishte e pajisur me instrumentet dhe materialet dentare, ku kryheshin ndërhyrje për mbushjen e dhëmbëve. Ndërhyrjet kirurgjikale kryheshin në klinikat private, me rekomandim të stomatologut dhe shpenzimet mbulohen nga të burgosurit.

Furnizimi me medikamente në institucion kryhet nga farmacisti, sipas rekomandimit të mjekut të institucionit, të siguruara nga fondi i ilaçeve të kontratës trepalëshe ndërmjet

⁸ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

FSDKSH-së, IEVP-së dhe depos farmaceutike, furnizimit nga sektori i shëndetësisë pranë DPB, si dhe ilaçet e blera nga fondi i vënë në dispozicion të IEVP-së.

Nga intervista online me stafin mjekësor të institucionit, u evidentua se dokumentacioni që administrohet prej tyre ishte i plotë, si regjistri për të sëmurët kronikë, regjistri i shpërndarjes së medikamenteve, regjistri i ilaçeve që siguroheshin nga familja, si dhe regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve. Këta regjistra, janë të sekretuar e të mbajtur në rregull. Kartelat mjekësore të të burgosurve janë gjithashtu të plotësuar dhe të përditësuara nga mjekët e institucionit dhe të mbyllura në dollap të veçantë me çelës.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për kryerjen sa më parë të investimeve për riparimin e instalimeve elektrike, kryesisht në dhomat e banimit, të cilat përbëjnë rrezik për sigurinë e jetës së të dënuarve.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për eliminimin e lagështirës në të gjitha dhomat e banimit të të dënuarve.
3. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e organikës të sektorit psiko social të institucionit me 1 punonjës psikolog dhe të 9 punonjësve të policisë të nivelit bazë, sipas strukturës së miratuar.
4. Marrjen e masave të nevojshme për gjetjen e mënyrave alternative për realizimin e takimeve fizike të të burgosurve me familjet e tyre, për shkak të kohëzgjatjes të periudhës së pandemisë.
5. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive, duke respektuar masat e parashikuara në protokollin shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në institucion.
6. Marrja e masave në kuadër të masave për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19, duke furnizuar me detergjentë shtesë të burgosurit, për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë vetjake, si dhe mjediseve të banimit dhe ambienteve të përbashkëta.
7. Marrjen e masave të nevojshme, për instruktimin e vazhdueshëm të stafit të institucionit, për zbatimin me rigorozitet të protokollit shëndetësor për parandalimin e

COVID-19, si dhe furnizimin e tyre me maska mbrojtëse, dizifektantë dhe doreza për mbajtjen pastër të duarve.

8. Marrjen e masave për ndryshimin e Urdhërit të përbashkët nr.104/5 prot. datë 19.06.2006 të Ministrit të Drejtësisë dhe nr.205/5 datë 27.07.2006 të Ministrit të Shëndetësisë, “Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit”, me qëllim përmirësimin e larmisë të menysë së ushqimit të të burgosurve.
9. Marrjen e masave të menjëhershme, për dezinfektimin sipas nevojës të ambienteve në regjimin e brendshëm, për të eliminuar praninë e insekteve.
10. Marrjen e masave të nevojshme për shtimin e numrit të kamerave të sigurisë në ambientet e brendshme të institucionit.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për sistemimin e personave që ndodhen në dhomat e observimit përtej afatit ligjor, në një nga sektorët e IEVP Rrogzhinë ose transferimin e menjëhershëm të tyre nga DPB-ja në institucion tjetër, pavarësisht masave kufizuese për shkak të pandemisë.
12. Marrjen e masave të nevojshme, për shtimin e posteve të dusheve sipas sektorëve ose lejimin e kryerjes së dusheve të burgosurve në intervale më të shpeshta, sipas parashikimeve në Rregulloren Evropiane të Burgjeve.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA